



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

Shtojca 1. DT

Autoriteti Kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, njofton modifikimin e dokumenteve të tenderit dhe shtyrjen e afatit të dorëzimit të ofertave në tenderin me objekt: “Rindërtimi i banesave individuale, ndërtimi dhe rikonstruksioni i infrastrukturës publike dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave” me REF-56909-04-27-2020, si vijon:

I. Në DST në shtojcën e njoftimit të kontratës, në pikën 2.6 tek seksioni 2 I ‘Njoftimit të kontratës’ në lidhje me kushtet që do zbatohen në rihapjen e konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike shënim:

Ishte: *Shënim: Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do t’i lejohet të bëjë ndryshime të çmimit / ofertës referuese të paraqitur në fazën e parë.*

Bëhet: *Shënim: Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe do t’i lejohet të bëjë ndryshime vetëm në ulje të çmimit / ofertës referuese të paraqitur në fazën e parë.*

II. Në DST tek udhëzimi për operatorët tek seksionin 5, në pikën 5.7.2, autoriteti saktëson tek formula, ishte $Z_M = 90 \% Mo$, bëhet $Z_M = 85 \% Mo$.

III. Afati kohor për dorëzimin e ofertave:

Ishte:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 08.05.2020 ora 12:00.

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 08.05.2020 ora 12:00.

Bëhet:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 15.05.2020, ora 12:00.

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 15.05.2020, ora 12:00.

Pjesë përbërëse të shtojcës gjeni një sqarimin si më poshtë:



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

Lënda: S Q A R I M

Objekti: “Rindërtimi i banesave individuale, ndërtimi dhe rikonstruksioni i infrastrukturës publike dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave.”

Drejtuar operatorëve ekonomikë

Të nderuar operatorë,

Pranë autoriteti është depozituar një kërkesë për sqarim lidhur me disa zëra në preventiv. Autoriteti në përgjigje të kërkesës bënë publike përgjigjet për çdo pyetje me qëllim për të informuar të gjithë operatorët ekonomikë.

Pyetja e parë;

- 1- Prishja e objekteve ekzistuese, germimi i dherave dhe depozitimi i tyre duhet përfshirë në perlllogaritjen e ofertes?

Përgjigje: Po, duhet përfshirë në perlllogaritjen e ofertes prishja e objekteve ekzistuese, transporti dhe evadimi i mbetjeve, germimi i dherave dhe depozitimi i tyre.

Pyetja e dytë:

- 2- Tek projekti konstruktiv, xokoli dhe shtresa betonike janë me beton të armuar apo vetëm beton?

Përgjigje: Siç paraqitet në projektin konstruktiv, me beton të armuar.

Pyetja e tretë:

- 3- Tek projekti i kondicionimit do të përfshihet vendosja e pajisjeve?

Përgjigje: Pajisjet e kondicionimit nuk janë të përfshira.



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

Pyetja e katërt:

- 4- Tek projekti sanitar pajisjet janë inkaso ndërsa tek përshkrimi i zerava, nuk specifikohet. Pajisjet duhet të vendosen inkaso apo të thjeshta?

Përgjigje: Pajisjet hidrosantire do të jenë inkaso siç janë të paraqitura në projektin sanitar.

Pyetja e pestë:

- 5- Tek projekti sanitar është përcaktuar panel diellor për ngrohjen e ujit sanitar. Duhet përfshirë në përlogaritjen e ofertës paneli diellor?

Përgjigje: Paneli diellor, nuk është i përfshirë në përlogaritjen e ofertës

Pyetja e gjashtë:

- 6- Tek projekti elektrik duhet përfshirë në përlogaritjen e ofertës vendosja e ndriçuesave?

Përgjigje: Në përlogaritjen e ofertës, nuk duhet përfshirë vendosja e ndriçuesave, por duhet të përfshihet vendosja e portollambave dhe llampave.

Faleminderit!